



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 06/07/2021.
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 04/574



Republika e Kosovës
Komuna Malishevës

PROCESVERBAL

Diskutim publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024

Me kryetarët e fshatrave

Mbledhja u mbajtë me datë: 25.06.2021 dhe filloi në ora 11.00.

Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 21 kryetarë të fshatrave, drejtorë komunal, kryesuesi si dhe zyra për informim.

Valon Mazreku: Përshëndetje për të gjithë, përshëndetje kryesues, kolegë drejtorë përfaqësues të KFORIT si dhe kryetarë të fshatrave të komunës së Malishevës.

Qëllimi takimit është diskutimi publik rreth Kornizës Afatmesme buxhetore për vitin 2022-2024.

Si cdo organizatë tjetër edhe Komuna Malishevës e kemi pranuar qarkoren Buxhetore nga Ministria Financave e kemi përpunuar këtë qarkore e kemi nxjerrë edhe qarkorën e mbrenshme Buxhetore ku për vitin 2022 sipas formulës së shpërndarjes së Granteve nga niveli qendror për nivelin komunal, Komuna Malishevës total buxhetin për vitin 2022 do ta ketë 15,655,757 euro nëse e krahasojmë me vitin aktual 2021 e kemi një rritje prej 3,75% apo në vlerë monetare 528,839 euro.

Kjo është një rritje e buxhetit për vitin 2021 krahasuar me këtë vit ndërsa buxheti për vitin 2023-2024 këtu e kemi një rritje në raport me vitin 2022 dmth për vitin 2023 sipas qarkorës Buxhetore kjo është një projeksion nuk është definitive mundë të ndryshojë është për 1 milion më shumë, ndërsa për vitin 2024 afërsisht 2 milion më shumë është planifikuar me pas buxhet se sa vitin që jemi.

Në Kuadër të kësaj rritje, rritja ka ardhur në tri programe në programin e Administratës së përgjithshme e kemi një rritje prej 6.02% ose prej 317,617 euro dhe në programin e Arsimit 211,222 euro ndërsa programi i shëndetësisë nuk është planifikuar rritje nga niveli qendror për Komunën e Malishevës.

Ne i kemi publiku edhe kornizën afatmesme këto mjete këtë total të buxhetit e kemi shpërndarë në 5 kategori ekonomike duke u bazuar në ndarjen ose shpërndarjen siq e kemi në këtë vit të kategorive ekonomike duke shtuar plus rritjen që është bërë prej 530.000 përafërsisht që e kemi shpërndarë në disa programe të kategorive ekonomike.

Komuna jonë në Administratën publike duke përfshirë administratën komunale, Arsimin dhe Shëndetësinë i kemi 1297 të punsuar për këta të punsuar kategoria e pagave është 8,591,643 euro ndërsa kategoria mallrave dhe shërbimeve i kemi 1,679,730 euro kategoria e shpenzimeve komunale që i paguan komuna 455.000 euro, subvencione i kemi planifikuar 400.000 euro dhe investime kapitale 4,529,384 euro nëse e krahasojmë me shpërndarjen e vitit aktual rritjen e kemi pasqyru kryesisht tek kategoria e investimeve kapitale ndikuar rreth 400.000 euro i kemi rritë investimet kapitale për vitin 2022.

Kjo është ndoshta kategoria që na intereson më së shumti për faktin që vetëm përmes investimeve kapitale mund ta zhvillojmë qytetin tonë dhe komunën e Malishevës ndërsa kategoritë tjera janë kryesisht kategori shpenzuese të cilat nuk ndikojnë aq shumë në zhvillim mirëpo mund të ndikojnë në raste specifike.

Kjo është sa i përket Buxhetit për komunën e Malishevës në kuadër të kësaj kornizes kemi paraqitur edhe objektivat tona të komunës ku disa prej objektivave kryesore të paraqitura në këtë dokument në këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve janë që të kemi mundësi dhe ti shfrytëzojme të gjitha burimet tona për përmirësimin e infrastrukturës rrugore ose infrastrukturën toksore duke përfshirë asfaltimet, rrugt, kanalizimet, trotualet dhe ndriqimi publik si dhe instalimit të rrymës në formë toksore kjo është njëra ndër objektivat kryesore që ne pretendojmë për me realizu gjatë kësaj periudhe afatmesme.

Ateherë dokumenti që ju shpërndamë është një formular standard dhe kërkohet nga propozuesit e projekteve që për secilin projekt ta plotsojme nga një formular të tillë ku këtë formular nuk po kërkoj me mbushë sot sepse ne jemi vetëm në fazën fillestare të hartimit të buxhetit patjetër që do të kemi edhe takime tjera pasi që diku ka java e dytë e muajit Korrik neve do të na vije edhe qarkorja dytë buxhetore në kuadër të qarkorës së dytë buxhetore percaktohen edhe kufitë buxhetor në kuadër të kategorive ekonomike.

Unë nuk kam diqka tjetër sa i përket kësaj, këto takime që do të mbajmë me kryetarët e fshatrave do të kompenzohen.

Ateherë unë po hapi debat nëse keni diqka me diskutu.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve ju falënderoj për kohën dhe hapsirën që keni gjetë me ardhë me debat për kornizën afatmesme buxhetore 2022-2024. Një falënderim të veçantë për punën që e keni kry gjatë pandemisë unë jam i vetëdijshëm që keni pasë një obligim dhe një barrë shumë të rëndë dhe ju falënderojmë shumë për punën që keni bërë, ndoshta shpesh e keni rrezikuar edhe jetën tuaj për të furnizuar familjet të cilat kanë pasur nevojë gjatë pandemisë e di që keni bërë edhe shpenzime në këtë drejtim por kuvendi komunal do të kryejmë obligimet ndaj jush.

Nëse na lejohet ne si kuvend do të dalim me bërë dëgjimin publik për shkak se edhe ligji për Financa ashtu e parasheh vitin e kaluar nuk kemi mundur me dal për shkak të pandemisë besojë që këtë vit deri me 1 Gusht besojë që do të dalim.

Valon Mazreku: Faleminderit Kryesues, secili prej juve mundeni me marrë fjalën.

Asllan Buzhala: A ka nevojë që të shkruhen projektet veq e veq me specifikat dhe kërkesat që plotësohen dhe me i dorzu te gjitha së bashku, dhe ne kemi ba shumë herë kërkesa dhe asnjëherë nuk janë realizu dhe nuk po di a me i shti prap qato projekte apo me shënu projekte të reja?

Nebih Bibaj: Unë jam Nebih Bibaj nga fshati Lladrovci i përshëndes të gjithë kryetart e fshatrave si dhe drejtorët që janë të pranishëm këtu në sallë. Unë kisha disa kërkesa, realizimin e projektbuxhetit që është votu për vitin 2021 sepse a do të përsëritim kërkesat e vjetra apo do të fusim kërkesa të reja. Mirë është që me u kry kërkesat që janë votu për 2021 sepse ato kanë qenë në vitin 2019 dhe janë bartë në vitin 2021, sepse me 30 Shtator votohet projektbuxheti për vitin 2022 dhe nëse ne i bijmë kërkesat e reja për me i futë në projektbuxhetin e vitit 2022 ato të cilat nuk janë realizu në 2021 ku mbesin? Kjo është një ndër shqetsimet tona edhe si kryesi e fshatit sepse kemi bartur shumë projekte nga viti 2019 deri ne vitin 2021 dhe kërkoj që projektet e reja që do të futen në projektbuxhetin 2022 të mos përsëriten si ato më parë faleminderit.

Valon Mazreku: Faleminderit Nebih, urdhno Fehmi Kryeziu.

Fehmi Kryeziu: Edhe unë kisha të njëjtin shqetësim ato projekte që ende nuk kanë përfunduar do të përsëriten prap, por shpresoj të mos përsëriten.

Hajrush Kavaja: Përshëndetje për të gjithë drejtorët dhe kryetarët e fshatrave nuk deshta shumë me zgjatë por kërkoj që projektet e parapara të realizohen unë deshta me ba edhe një pyetje tjetër ne e kemi ujësjellsin nga projekti kalum ka filluar në fshatin tonë faza e parë ka përfunduar por ka ngecur për trafë elektrike dhe kërkoj nga ju që te realizohet mundësisht sa më shpejtë.

Valon Mazreku: Faleminderit kryetar.

Mefail Elshani: Edhe unë pajtohem me parafolësit për këto projekte që nuk ka nevojë ndoshta me i përsërit shqetësimet që i patën ata edhe unë i ndaj bashkë me ata pasi që një kohë të gjatë nuk kemi marrë pjesë në takime me kryetarët e fshatrave unë deshta me ju njoftu që në fshatin Ngucat e kemi marrë një iniciativë kryesia e fshatit bashkë me organizatat e dala nga Lufta te UÇK-së për ndërtimin e monumentit të UÇK-se në kodrën e UÇK-së. Qëllimi ka qenë që me i kujtu vlerat e luftës atyre që i kanë harruar ato vlera dhe njerzit që e kanë qliruar dhe kanë vepruar për Kosovën.

Unë dëshirojë përmes kryetarve të fshatrave ti falenderoj të gjithë ata që kontribuan në ndërtimin e këtij kompleksit memorial.

E falënderoj shumë kuvendin komunal për kontributin që e ka dha edhe në formë morale edhe me participimin e mjeteve një donacion për rregullimin e këndit të lojrave për fëmijë.

Ju falënderoj të gjithëve.

Valon Mazreku: Faleminderit kryetar.

Bajram Bytyqi: Kërkoj realizimin e projekteve 2019-2021 në mënyrë që të mos përsëriten në projektbuxhetin 2022.

Ne e kemi pasë një projekt për ndërtimin e sallës së sportit në fshatin Lumishtë ka hyrë në buxhet të Ministrisë së Kulturës në Prishtinë mirëpo thuhet se nuk është hekur por a duhet që kuvendi me shpallë tender sepse këtu nuk e kam të qartë?

Arbër Paqarizi: Së pari uroj që këto projekte që do të realizohen të bëhen në mënyrë transparente po ashtu vlenë të ceket se këto projekte realizohen nga buxheti i komunës e buxheti i komunës grumbullohet nga taksat e qytetarve andaj kërkoj nga kryesia e ekzekutivit që këto projekte të bëhen me një kualitet dhe cilësi më të lartë.

Sa i përket fshatit Dragobil, urojë që të ketë më shumë investime sepse gjatë 8 viteve shumë është premtuar e pak janë realizuar dhe shumë projekte janë realizuar nga kontributet e banorëve të fshatit Dragobil andaj parashtroj kërkesën që këto projekte që do ti paraqes me prioritet të merrën parasyshë dhe të realizohen nga ana e ekzekutivit.

Lulzim Mazreku: Përshëndetje për të gjithë jam përfaqësuesi i qytetit të Malishevës, sa i përket investimeve dhe kërkesave që i kemi bërë besoj që kemi ba kërkesa mjaftueshëm por nuk janë realizuar shumica prej tyre, mirëpo deshta me ba një pyetje konkrete për disa investime që kanë fillu me u realizu por kanë mbetë në gjysmë p.sh aka ndonjë hartë zonale për investimet kah do të realizohen dhe a keni plan konkret per ndonje projekt që e nisni dhe përfundoni shembull konkret te rruga "Pavarësia" që veq është filluar me u ba dhe ka mbetë pra ku është problemi që nuk është realizu, dhe rruga që shpie për në Banjë sepse në vërshimet e kohëve të fundit menjëherë ajo rrugë është blloku, dhe për lumin i cili ka filluar që sa vite me u perfundu por akoma nuk është realizuar ku është problemi?

Valon Mazreku: Faleminderit Kryetar.

Besim Ramaj: Përshëndetje për të gjithë unë këtu do ta shprehi një shqetësim të vogël është problemi te ujësjellsi që është ndërtuar në fshatin Senik rrjeti i Hidroregjionit që është ndertuar dhe kam kërkesën e banorve të fshatit dhe paknaqësite e tyre që është duke u shfrytëzu uji nga fshati Drenoc dhe Carrallukë. Neve na është kërkuar kyqja me mjete vetanake dhe kam dëshirë me ditë qysh qëndron puna a është në dijeni komuna për këtë projekt që shfrytezohet në mënyre jo të rregullt nga banorë të fshatrave të tjerë dhe qysh mujna me u kyq ne si fshat në këtë ujësjellës.

Valon Mazreku: Faleminderit Kryetar, urdhno Luan.

Luan Bytyqi: Përshëndetje për të gjithë jam përfaqësues nga fshati Shkozë dua ti shprehi shqetësimet e banorëve rreth projekteve që kanë qenë në fshatin tonë. Projektet që kanë qenë për mu bartë prej vitit 2019 në vitin 2020 nuk janë realizu akoma edhe në vitin 2021 shpresojmë që të paktën ato projekte të realizohen këtë vit dhe projektet e reja të futen në projektbuxhetin e vitit 2022. Nuk dua të shtoj më tepër ju uroj suksese në realizimin e projekteve investive në komunën dhe fshatrat e Malishevës.

Valon Mazreku: Faleminderit Kryetar.

Gzim Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë jam kryetari i fshatit Pagarushë edhe unë si të gjithë kryetart tjerë kam ardhë sot me i ngrit shqetësimet e banorëve të fshatit deri tani ndëgjova parafolësit fshatrat tjera po qëndrojnë mirë me investime në krahësim me fshatin Pagarushë.

Deshta mju pyet për një projekt të ujësjellësit i cili ka fillu me u realizu që 5 ose 6 vite dhe akoma nuk ka përfundu.

A do të realizohet ky projekt?

Valon Mazreku: Faleminderit Kryetar, urdhno Arben.

Arben Sopaj: Përshëndetje për të gjithë jam përfaqësues i fshatit Janqist kam shqetësimin e banorve sepse kemi një rrugë e cila i lidh 3 fshatra pjesa me Shkozën është kry tash ka mbetur fshatit Janqist me rrugën në Pagarushë dhe ende nuk është realizuar po ashtu kanalizimet kanë mbetur të hapur në një pjesë të fshatit po ashtu pjesa e ndriqimit publik nuk është realizuar po ashtu edhe te pjesa e ujësjellësit thuhet që është bërë përrurimi i rezervuarit të ujit është lëshuar në funksion por akoma nuk janë kyqur banorët e fshatit Janqist.

A keni ju ndonjë informacion për këtë qështje sa i përketë ujësjellësit të fshatit Janqist? Ju Faleminderit dhe suksese për të gjithë.

Valon Mazreku: Faleminderit Kryetar atëher nëse nuk ka dikush tjetër pyetje do të mundohem të ju jap përgjigje ashtu siq unë di, disa pyetje kanë qenë të ngjashme sikur rasti i projekteve që janë bartë nga vitet paraprake në këtë vit. Po i drejtohet Asambleistit tonë që e kemi nga fshati Lladroc Nebih Bibaj ende nuk është bërë alokimi mjeteve nga niveli qendror për investime kapitale, projektet të cilat janë në vitin 2021 do të realizohen të gjitha, madje projektet e kanalizimit të cilat janë në rrugë dhe janë për vitin 2021 ne i kemi tenderu dhe vlera e këtyre projekteve diku është rreth 1.1 milion dhe të fillojnë të realizohen në javën e parë të muajit Korrik.

Ajo që më bani përshtypje është kryetari i fshatit Ngucat rreth kompleksit memorial është një iniciativë e fshatit Ngucat e përkrahur nga fshatrat tjerë mërgimtarët dhe gjithë ata njerëz të vullnetit të mirë që kanë konsideruar që UÇK-ja është vlerë kombëtare dhe askush nuk mundet me i dhanë ngjyre tjetër përveq ajo që është shkruar gjatë Luftës.

Ne jemi të gatshëm për me përkrah këtë kompleks memorial janë në procedurë për shkak të pronës ndoshta keni informacione pra komuna është e gatshme dhe ka nda një pjesë të mjeteve për kompletimin e kompleksit memorial "Kodra e UÇK-së".

Dikush e ngriti qështjen e kualitetit në fakt krahasuar me komunat tjera sa i përket investimeve jemi shumë përpara me investime mirëpo kemi ende projekte të shumta për ti realizuar dhe duhet me rritë vigjilencen dhe me e kërku ngritjen e kualitetit të investimeve por ne jemi në vazhdimsi te punimit qe secili kontraktues që merr përsipër realizmin e projekteve ta realizoj ashtu siq e ka të kontraktune.

Te ujësjellsi në fshatin Temeqinë në fshatin Janqist, Senik dhe në fshatin Pagarushë. Në fshatin Senik është ndërtu rezervuari i ujit nga granti i performancës e mbështetur nga qeveria Zvicrrane përmes Demosit dhe MAPL-së detajet ma tepër nuk i di a është i destinuar vetem për fshatin Senik apo edhe fshatrave tjerë.

Sa i përket investimeve që i përmendi kryetari i qytetit të Malishevës nfakt ne kemi filluar me rregullu rrugën "Pavarësia" ky ka qenë projekt i vitit të kaluar dhe kemi pas problem me shtyllat elektrike por që bashkarisht e kemi zgjidhur këtë problem me Kedsin e shumë shpejtë do të fillon rregullimi i kablllove nëpër shtyllat e reja elektrike.

Por i njëjti problem është edhe në rrugën "Skënderbeu" që shpije për Banjë është një projekt i komunës në bashkëfinancim me qeverinë Zvicrrane përmes grantit të performancës dhe Demosit ku gjysma e projektit është financuar nga ai grant dhe gjysma tjetër nga buxheti komunal, punimet janë në fazën përfundimtare do ta ketë edhe një shtresë të dytë të asfaltit i cili do të jetë balancues dhe do ta kompletoj si projekt të tillë.

Sa i përketë vërshimeve këto ndodhin ne kemi pasë vërshime këtë vit dhe jemi mundu me i menaxhu në formën më të mirë të mundshme që edhe damet të kenë shkallë sa ma të vogla.

Sa i përketë shtratit të lumit unë kisha kërku me iu drejtu qeverisë së Kosovës se pse ikan hek mjetet atje nga projekti për shtratin e Lumit edhe ne vitin 2020 edhe ne vitin 2021 ka qenë projekt i financuar nga buxheti qëndror ky projekt është futë atje falë përfaqësimit tonë politik atje që e kem pasë dhe është ndërpre përshkak se nuk ka pasë burime apo mjete për at projekt dhe ka mbetë në gjysmë, ndërsa pjesa tjetër që është duke u investuar tash të gjitha mjetet janë te financuar nga buxheti i komunës dhe janë intensivisht punimet duke u kryer.

Ujësajllsi në Pagarushë ka filluar diku në vitin 2017 kemi pasë probleme aty për shkak të pronave besoj që je në dijeni ne tani si komunë ikemi nda disa mjete për implementimin e projektit të ujësajllsit ne fshatin Pagarushë mirëpo asambleisti i fshatit Pagarushë ka kërkuar që ky projekt mos të realizohet pastaj kuvendi e ka marr vendimin sepse i ka besuar asambleistit të fshatit tuaj.

Sa i përketë sallës së sportit në Lumishtë është një projekt i buxhetun në nivelin qëndror është i buxhetun edhe në këtë vit dhe ka qenë edhe vitin e kaluar diku rreth 50.000 euro janë të ndara këto mjete janë të pamjaftueshme për mu ndërtu një sallë e sportit atje. Ne kemi kërku që këto projekte që janë nga niveli qëndror të realizohen, nese kërkohet bashkfinancim nga komuna ne jemi të gatshëm të sigurojmë mjete bashkë me kuvendin për me inicu këto projekte që janë në të mirën tonë.

Milazim Morina: Përshendetje për të gjithë faleminderit për pjesmarrjen sa i përketë ujësajllsit e di që uji është burim i domosdoshem për jetesë andaj kërkoj që të ndahet një fond dhe të gjitha fshatrat të kenë kyqje në ujësajlls andaj do të organziojme nje mbledhje do ta ftojme edhe kryetarin do ta thirrime edhe drejtorin e Hidroregjionit dhe do të diskutojmë, ju faleminderit.

Valon Mazreku: Faleminderit drejtor, ju mbeta ndoshta borxh, investimet sa i përketë ujit gjithmonë ika ba komuna Malishevës në shumë raste kur kemi pasur edhe burime tjera të financimit duke e falenderu edhe qeverine Zvicrrane e cila ka qenë donatore më e madhe sa i perket rrjetit të ujit mirëpo komplet investimi që bahet nga komuna bashkë me donator përgjegjëse është kompania e Hidroregjionit sa i përketë kyqjeve.

Arbër Paqarizi: Pytja e parë ka të bëjë me drejtorinë e shërbimeve publike se a parashihet ndonjë projekt për evitimjin e rrezikut nga qentë endacak brenda komunës tone dhe në fshatra dhe pytja e dytë është për drejtorin e inspetoriatit z.Dibran Kastrati se qfarë masa do të merr kjo drejtori në mbrojtjen e të drejtave të puntorve?

Valon Mazreku: Po Arbër është pak shqetësuese por qentë endacak është problematik nacionalë ne kemi ba perpjekje me gjetë ndonjë modalitet të trajtimit të kësaj dukurie mirëpo patjetër që ne me drejtorinë e Bujqësisë do të mundohemi të gjejmë një modalitet të trajtimit të kësaj dukurie, sa i përket inspektoriatit pra inspektoriati i punës nuk menagjohet nga niveli lokal komplet është në kompetencë të nivelit qëndror.

Faleminderit për secilin që keni nda kohën me marrë pjesë në këtë dëgjim publik sa i përket kornizës afatmesme buxhetore 2022-2024 shiehmi në takimet e radhës.